

Weber: Përkushtimi i Gjermani

Arbana Mjekiçi

PRISHTINË, SHTATOR – Gjermania do të vazhdojë të ketë rol aktiv në BE dhe në Ballkanin Perëndimor edhe pas zgjedhjeve. Me një fitore të pritur të Merkelit dhe me gjithë mundësinë që negociatat për formimin e koalicionit qeveritar gjerman të zgjasin më tepër se zakonisht, Qeveria e re gjermane, nga fillimi i 2018-s do të vazhdojë përpjekjet për stabilizimin e BE-së, pas 2016-s katastrofike. Në këtë kuadër do të punohet edhe sa i përket stabilizimit të Ballkanit Perëndimor, ndonëse dy nismat për rajonin ndodhen në krizë të thellë, ka thënë Bodo Weber, analist politik në Berlin dhe anëtar i lartë i Këshillit të Politikave për Demokratizim në Ballkanin Perëndimor.

Në një intervistë për “Kohën Ditore”, Weber po ashtu flet për formulat e mundshme të formimit të qeverisë në Gjermani, përderisa konsideron se mundësia që partia populiste AfD, të shndërrohet në forcën kryesore opozitare në Parlamentin gjerman nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në politikën e jashtme të Gjermanisë dhe politikën e saj karshi BE-së. Sidoqoftë, sipas tij, presioni populist i dy vjetëve të kaluar në Gjermani e ka bërë të veten.

Weber ka folur edhe për dialogun Prishtinë-Beograd, të ndërmjetësuar nga BE-ja, ku rol aktiv ka pasur Gjermania. Ai sugjeron një “masterplan” Gjermani-BE, në të cilin do të përcaktohej caku përfundimtar. Cak përfundimtar do të duhej të ishte pranimi i Republikës së Kosovës nga Serbia, si dhe anëtarësimi i të dyjave në BE. Me këtë do të sigurohej garanci për serbët e Kosovës se ata do të kenë një të ardhme në Kosovë, ndërsa për shqiptarët se nuk do të vihet në rrezik shpërbërja apo ndarja e shtetit të Kosovës.

KD: Të dielën votuesit gjermanë do të hedhin votën e tyre në zgjedhjet e përgjithshme në këtë shtet. Çfarë mund të pritët prej këtyre zgjedhjeve?

Weber: Në këtë fushatë zgjedhore është parë një përplasje interesante e dëshirës së gjermanëve për stabilitet dhe kontinuitet, gjë kjo e mishëruar në epërsinë në sondazhe për kancelaren Merkel dhe partinë e saj CDU, ashtu si edhe në hezitimin e partive të etabluara për të hapur tema të pakëndshme, si e ardhmja e BE-së apo thyerja që pësoi udhëheqësia mbi BE-në e

Berlinit gjatë krizës me refugjatë, e përjetuar në të gjitha zgjedhjet gjatë dekadës së kaluar, ashtu si edhe një shqetësim për një botë të pasigurt dhe jostabile, e mishëruar me ngritjen e forcave populiste, AfD-së. Sipas sondazheve, ne mund të presim një sukses të madh të CDU-së së Merkelit si partia më e madhe parlamentare, humbje substanciale të socialdemokratëve, SPD-së, si edhe hyrjen e katër partive më të vogla në parlament – “Linke” (e majta), të gjelbrit, rihyrja e liberalëve (FDP), si dhe hyrja për herë të parë e AfD-së populiste. Mund të ketë fazë më të gjatë sesa zakonisht të ne-

“Politika gjermane karshi Ballkanit Perëndimor nuk do të ndryshojë në mënyrë substanciale, pa marrë parasysh se cili opion mbizotëron në fund. Por më 2018, Qeveria e porsaformuar dhe Zyra e kancelares Merkel do të përballen me faktin se dy nismat politike të udhëhequra dhe të bashkiniciuara nga Berlini për rajonin gjatë dekadës së kaluar – dialogu dhe nisma BE-Bosnjë – kanë rënë në krizë të thellë”, thotë Weber

gociatave për formimin e koalicionit pas këtyre dy zgjedhjeve, teksa sondazhet lënë dy opsione, mbase si opsionet e vetme të mundshme – një koalicion i ri i madh, ashtu si edhe një koalicion i ashtuquajtur “Koalicioni Xhamajka” (CDU, Të gjelbrit, FDB) – teksa të dyja opsionet do t’i jepnin partnerëve potencialë të CDU-së kokëçarje për t’u pajtuar rreth hyrjes në qeveri.

KD: AfD-ja e krahut të djathtë, sipas sondazheve, pritet të hyjë në Parlament. Pasi që të gjitha partitë e kanë hedhur poshtë bashkëpunimin me këtë parti, ajo pritet të bëhet forca më e madhe opozitare. Duke e pasur parasysh qëndrimin e saj rreth shumë çështjeve (shembull BE-ja dhe imigrantët), cili do të jetë ndikimi i saj mbi politikën e jashtme gjermane?

Weber: Paj, forca më e madhe opozitare do të jetë partia që nuk hyn në qeveri dhe që ka pjesën më të madhe të votave. Sipas sondazheve të reja, në rast se arrihet sërish marrëveshje për koalicionin e madh, AfD-ja mund të mbetet partia më e madhe opozitare parlamentare, por kjo mund të mos ndodhë, pasi që rezultatet për partitë më të vogla janë shumë të ngushta. Sidoqoftë, ajo do të jetë partia e vetme që do të veprojë si opozitë e krahut të djathtë ekstremist. Si e tillë, impakti i saj direkt mbi politika do të jetë zero. Por, presioni populist gjatë dy vjetëve të kaluar i ka vënë elitat e etabluara politike nën presion, gjë kjo që në një masë të caktuar ka sjellë një transformim populist të diskursit politik dhe publik mbi çështjen e refugjatëve dhe të azilit. Me përjashtim të këtij ndikimi indirekt nuk shoh ndonjë ndikim tjetër relevant mbi politikën gjermane të jashtme dhe të BE-së.

KD: Nëse sondazhet dalin të saktë, kancelarja gjermane, Angela Merkel pritet që ta sigurojë fare lehtë edhe një mandat. Çfarë nënkupton kjo për BE-në si tërësi, posaçërisht pas një periudhe paqartësish dhe turbulencash?

Weber: Së pari nënkupton një vazhdimësi të trendit të 2017-s për ristabilizim pas 2016-s, që ishte një vit katastrofik për BE-në. Pas formimit të qeverisë, faktikisht prej fillimit të 2018-s, ne mund të presim një debat serioz dhe një betejë të brendshme midis shteteve anëtare rreth reformave në BE, përfshirë Eurozonën. Me shfaqjen e presidentit Macron në Francë, ka shpresë për një ripërtëritje të aksit franko-gjerman, si shtyllë tradicionale e BE-së, derisa në të njëjtën kohë ka dallime substanciale midis Parisit dhe Berlinit rreth rrugës që duhet të merret për të ecur përpara, dallime këto që nuk janë përmendur në periudhën para zgjedhjeve gjermane. Të mos flasim këtu për dallimet me shtetet e tjera anëtare, ekstremi i të cilave janë ato me Poloninë dhe Hungarinë. Por, këto do të jenë përplasje me qëllim të ecjes përpara, që do të ndodhin në kuadër të një momentumit të ri të një vetëbesimi të Unionit.

KD: Gjermania ka qenë një prej akterëve më aktiv ndërkombëtar në Ballkan. A mund të ndryshojë politika gjermane karshi Ballkanit, pas këtyre zgjedhjeve?

TË DEMOKRATIZIMIT (DPC) NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BODO WEBER

së për Ballkanin do të vazhdojë



“Me shfaqjen e presidentit Macron në Francë, ka shpresë për një ripërtëritje të aksit franko-gjerman, si shtyllë tradicionale e BE-së, derisa në të njëjtën kohë ka dallime substanciale midis Parisit dhe Berlinit rreth rrugës që duhet të merret për të ecur përpara, dallime këto që nuk janë përmendur në periudhën para zgjedhjeve gjermane. Të mos flasim këtu për dallimet me shtetet e tjera anëtare, ekstremi i të cilave janë ato me Poloninë dhe Hungarinë”, thotë analisti Weber

Weber: Politika gjermane karshi Ballkanit Perëndimor nuk do të ndryshojë në mënyrë substanciale, pa marrë parasysh se cili opcion mbizotëron në fund. Por më 2018, Qeveria e porsaformuar dhe Zyra e kancelares Merkel do të përballen me faktin se dy nismat politike të udhëhequra dhe të bashkiniciuara nga Berlinit për rajonin gjatë dekadës së kaluar – dialogu dhe nisma BE-Bosnjë – kanë rënë në krizë të thellë.

KD: Cili do të jetë roli gjerman në procesin politik të Kosovës (në dialog, integrim evropian)?

Weber: Pas zgjedhjeve pres që Berlinit të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e ringjalljes së dialogut, të iniciuar nga Mogherini dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm i Evropës (EEAS) në korrik të këtij viti.

KD: Cili është mendimi juaj për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? Çfarë mendoni se do të mundë të bëhet për ringjalljen e këtij procesi?

Weber: Dialogu është zhytur në një krizë serioze, duke rrezikuar të dështojë. Sado jo-realist të jetë zbatimi i marrëveshjes së prillit të 2013-s deri në fund të këtij viti, vetë fakti se po e përjetojmë vitin e katërt të shtyrjes së zbatimit të plotë paraqet një dëshmi të qartë të kësaj krize. Siç ndodh edhe me humbjen e besimit të qytetarëve të Kosovës në proces. Sipas mendimit tim, që prej fillimit mungon një element kyç – një masterplan Gjermani-BE. Plani duhet të nisë me përcaktimin e cakut përfundimtar. Në këtë cak përfundimtar përfshihet, natyrisht, anëtarësimi në BE si i Serbisë ashtu edhe i Kosovës. Sipas meje duhet të përfshijë po ashtu edhe njohjen e Republikës së Kosovës si shtet nga Serbia. Nëse dikush mendon se caku përfundimtar mund të arrihet me diç-

ka nën nivelin e njohjes së plotë, atëherë ai/ajo duhet të dalë me një plan tepër bindës që garanton se Serbia nuk do të/nuk guxon të bllokojë procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE pas hyrjes paraprake të saj në bllok dhe që siguron shtetësinë e Kosovës, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe ndërkombëtar. Nuk po e kuptoj se si ideja e përmendur shpesh e kopjimit të marrëveshjes gjermano-gjermane mund ta sigurojë një gjë të tillë. Pastaj nga ky përfundim, një masterplan i tillë do të duhej t'i definonte shumicën e hapave të rëndësishëm që kanë çuar prapa. Një masterplan i tillë do të duhej të ishte kornizë për krijimin dhe konstruktimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe – duke i risiguruar serbët e Kosovës se do të kenë një të ardhme në këtë shtet nëpërmjet integritetit të plotë, ndërsa shqiptarët e Kosovës se nuk do të vihet në rrezik shtetësia e Kosovës dhe nuk do të nxitet ndarja.

© KOHA Ditore